



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GJIROKASTËR
KËSHILLI I BASHKISË

V E N D I M

Nr. 72, datë 31.10.2024

“PËR MIRATIMIN E SISTEMEVE TË PIKËZIMIT PËR PROGRAMET SOCIALE TË STREHIMIT”

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”i ndryshuar, ligjin nr. 48/2023 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin 22/2018 Për Strehimin Social”, konkretisht në nenin 15 bëhen ndryshime, ku pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me përmbajtje si vijon: “1/1. Sistemi i pikëzimit në total duhet të përmbajë 100 pikë, ku çdo kriter i përcaktuar në nenin 16, përmban 25 pikë dhe mënyra e shpërndarjes së pikëve brenda kriterëve bëhet vetë nga njesia e vetëqeverisjes vendore VKM nr.362 datë 29.05.2019 “Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe mënyrën e llogaritjes së tij” pika 2 dhe 2.1, VKM nr. 384 datë 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore” pika 12, VKM nr. 453 datë 03.07.2019 “Për masën e subvencionit të interesave të kredisë dhe procedurën e dhënies së tij për familjet që përfitojnë banesë me kosto të ulët, me kredi të lehtësuara nga shteti”. Me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e datës 31.10.2024

V E N D O S I:

1. Miratimin e sistemeve të pikëzimit për programet sociale të strehimit si me poshtë:
 1. Sistemi i pikëzimit për trajtimin sipas programit të Subvencionimit të Qirasë sipas aneksit nr.1 bashkëngjitur.
 2. Sistemi i pikëzimit për trajtimin sipas programit të Subvencionimit të Interesave të Kredive sipas aneksit nr.2 bashkëngjitur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Shërbimit Social dhe Shëndetësor
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas miratimit të tij.

SEKRETAR I KËSHILLIT

Etleva YZO

KRYETAR I KËSHILLIT

Merita ISARAJ